

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPËSTINA VUÇITRËN

Nr. / Br. 21861/26

Nr. i fq. / Br. st. - 14 -

Data: / Datum: 29.05.2026

VUSHTRRI - VUÇITRËN



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vuçitrn – Municipality of Vushtri



Kuvendi i Komunës

01. Nr. PB-90/26 28/05/2026

PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRIË, MBAJTUR MË 30 PRILL 2026

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, duke filluar në ora 10:15.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë si: Behar Duraku, Berat Sadiku, Betim Grabanica, Blerina Shala, Diellza Pllana, Drita Dibrani, Edmond Hyseni, Fakete Dushi, Fatmire Cecelia, Fidan Bejta, Gentiana Rama, Gresa Muli, Isak Uka, Kushtrim Hyseni, Kushtrim Veseli, Leonora Gërguri, Mek Selaci, Melihate Basholli – Latifi, Mensur Kastrati, Mentor Ferizi, Mentor Hasani, Nasuf Aliu, Ramadan Parduzi, Pëllumb Maliqi, Refik Maloku, Rrahim Ajeti, Stefan Markovic, Vlerë Tahiri, Xhon Gubetini dhe Ymer Haradinaj.

Mungoi: Hava Mlinaku.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe z. Benjamin Shala, që e zëvendësonte Kryetarin e Komunës, përfaqësuesit e MAPL-së, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, - Kryesuese e Kuvendit, e cila konstatoi se në sallë janë prezentë 31 anëtarë të kuvendit, kuorum i plotë për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare dhe për marrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit- pasi i përshëndeti gjithë të pranishmit njoftoi se, anëtarët e kuvendit materialin e kanë marrë me kohë. Ndërkohë në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, e kemi larguar pikën 3 të rendit të ditës. Po atë, do ta diskutojmë pastaj kur hyjmë në diskutimet për rendin e ditës. Fillimisht hapi diskutim para rendit të ditës.

Berat Sadiku, anëtar i kuvendit-tha se diskuton para kuvendit, në emër të shefit të grupit parlamentar të LDK-së. I kemi disa çështje për me i adresuar. Kemi shpresuar sot që të kemi prezent Kryetarin e komunës pasi që edhe në seancën e kaluar nuk ishte këtu. Fatkeqësisht nuk e kemi as kryetarin as nënkryetarin. Po ju drejtohem i juve kryesuese, mirëpo edhe qytetarëve të komunës sonë. Këto ditë jemi dëshmitarë të disa ngjarjeve që kanë ndodhur në komunën tonë. E para, është blerja e dy veturave në vlerë 90.000 €. Vendimi për blerjen e këtyre dy veturave në këtë vlerë nga komuna e Vushtrrisë tregon një shkëputje nga realiteti në një kohë kur familjet përballen me rritje të kostos së jetesës, madje përballen me rritje tepër të mëdha edhe të shërbimeve bazike. Prioritet institucional duket të jetë thellësisht i gabuar kjo blerje në këtë vlerë. Këtu nuk është problemi te shumica, por te mesazhi që përcillet nga kryetari i komunës. Luksi për

administratën, ndërsa barra për qytetarët. Komuna ish dashur të ishte shembull i përgjegjësisë financiare, jo i shpenzimeve të panevojshme. Nuk e di nëse këto vetura janë në këtë kohë aq të nevojshme për administratën komunale. Prandaj pyeti kryetarin, nënkryetarin ose drejtorin e Shërbimeve Publike, nëse komuna ka alternativa të tjera më ekonomike. A ka transparencë të plotë mbi specifikat e këtij vendimi në vend të investimeve që prekin drejtpërdrejtë jetën e qytetarëve? - sikurse është infrastruktura, arsimi, shëndetësia apo lehtësimi i barrës financiare për qytetarët, zgjedhja për automjete të shtrenjta në këtë kohë, për neve si grup kuvendar është e papranueshme dhe patolerueshme. Po ashtu jemi dëshmitarë të një aktiviteti nga Drejtoria e Prokurimit që lidhet me shfrytëzimin e shërbimeve të fotokopjimit me qira dhe printimit për institucionet arsimore. Ky proces i tenderimit në komunën e Vushtrrisë është shembull tipik i keq menaxhimit dhe mungesës së qartësisë në vendimmarrje. Fillimisht tenderi është hapur në vlerën 24.000 € pastaj është anuluar për t'u rritur në vlerë 27.000 €, kemi prapë anulim të këtij tenderi dhe shuma finale ka shkuar deri në 30.000 €. Kjo ngritë dyshime normalisht serioze, a po përshtatet buxheti me tregun apo po përshtatet tenderi me ofertuesin? Kjo pyetje shkon direkt për kryetarin e komunës ose Drejtorin e Prokurimit. Arsyetimin që e kanë dhënë Drejtoria e Prokurimit se çmimet tejkalojnë buxhetin, bie poshtë në momentin kur vetë procesi përfundon duke ekspozuar një ofertë edhe më të lartë që është në kundërshtim me ligjin. Kjo tregon mungesë planifikimi real dhe një qasje jo profesionale. Për më tepër, vetë koncepti i marrjes me qira të këtyre shërbimeve të fotokopjimit për një periudhë të gjatë është i diskutueshëm edhe ekonomikisht. Në këtë vlerë prej 30.000 € euro do të ishte shumë e arsyeshme dhe me më e qëndrueshme që komuna të investonte në blerjen e pajisje duke ulur kostot afatgjatë dhe duke shmangur varësitë nga operatorët ekonomikë që i kemi. Andaj nuk duhet të kishim një improvizim të tillë nga një tender në tjetrin për transparencë në menaxhimin e parasë publike. Po ashtu jemi dëshmitarë që sa herë e shohim kryetarin e komunës nëpër intervista televizive kur ngritën shqetësime nga qytetarët e komunës sonë arsyetimi i kryetarit të komunës gjithmonë është kontrata kolektive. Ne mendojmë që këto deklarata të përsëritura nuk përbëjnë shpjegim për dëshmitë e mungesës së planifikimit serioz financiar dhe të një menaxhimi jo efikas të buxhetit të komunës. Jemi dëshmitarë që vitin e kaluar përmbaruesit i kanë marrë afër 3 milion euro për shkak të kontratës kolektive. Edhe këtë vit e dimë që një shumë e caktuar do të merren nga buxheti i komunës, mirëpo ajo çka ish dashur komuna jonë përkatësisht kryetar i komunës, që në vitin paraprak të planifikohej një kod i veçantë buxhetor për kontratat kolektive dhe assesit të vjen përmbaruesit dhe të merr para nga kodet buxhetore të komunës.

Refik Maloku, anëtar i kuvendit-pasi i përshëndeti gjithë të pranishmit deklaroi: dua me i ngrit nja dy - tri shqetësime në lidhje me atë çka po ndodh në komunën e Vushtrrisë. E para është kështu: pasnesër është 2 maji, është dita e masakrës, shënimi i ditës së masakrës më të madhe që ka ndodhur në komunën e Vushtrrisë edhe një prej më të llahtarshme që ka ndodhur në krejt Kosovën. Ne na duhet me shkuar në homazhe ose në përkujtim. Mirëpo është një problem kryesuese edhe kryetar, e kam fjalën për kryetarin, nuk e di çka ju kemi dhënë atyre njerëzve që kanë dhënë aq shumë për neve kur nuk jeni në gjendje, një rrugë me e rregulluar që sa vjet. Ne e dimë që është dashur me filluar ndërtimi i asaj rruge me 4 dhjetor 2024. Sot jemi në prill të 2026 afati për me u përfunduar ka qenë fundi i vitit që shkoj, e rruga nuk ka filluar edhe nuk është duke u bërë asgjë për atë rrugë. Domethënë ne kategoritë e dala nga lufta si Ushtri Çlirimtare, si dëshmorët, si martirët, ne veç jeni duke i shfrytëzuar kur po duam të kërkojmë ndonjë votë. Nuk jeni duke u interesuar asnjëherë për mirëqenien e tyre. Është e paimagjinueshme që ne pasnesër me shku në ato homazhe nëpër atë rrugë. Unë për vete personalisht nuk do të marrë pjesë për arsye se nuk e kemi kryer asnjë obligim ndaj atyre qytetarëve, së paku bre

një infrastrukturë normale me e bë, e jo diçka më shumë. Nuk e di kur do me filluar ajo rruga dhe a do të përfundoj ndonjëherë. Kisha pas qejf me pas përgjigje prej kryetarit se është turp ne pasnesër me shku aty edhe me tentuar me dhënë arsyttime banale duke i ikur përgjegjësive tona që na takojnë. Dhe çështja e dytë që dua ta ngriti është se, jemi dëshmitarë të uzurpimit masiv të tokës bujqësore në tërë komunën e Vushtrrisë sidomos në rrugën që qon për Akrahticë dhe pjesën për fshatin Shtitaricë edhe rruga kryesore nga magjistralja me dhjetëra objekte janë duke u ndërtuar në tokë bujqësore, jam i sigurt se të gjitha janë pa leje ndërtimore, thjesht ky pushtet është jo funksional për t'i ndalur këto ndërtime të egra. Pyetje për Drejtorin e Drejtorinë së Inspektoratit, a është duke inspektuar ndërtimet dhe a është duke u marrë dikush me to? - Pyetja e tretë që dua me e ngrit është kjo çështje: Para disa ditësh ose javësh e keni pasë një vizitë në Shqipëri, një numër i madh i zyrtarëve komunal. Pyetja është kjo: cili ka qenë qëllimi i kësaj vizite? Sa para janë shpenzuar për atë vizitë, kurë, duke pasë parasyshë që ju kur vjen puna te pagesa e punëtorëve teknik nëpër shkolla i vononi nga dy tre javë me arsytimin që nuk keni mjete ndërsa për me realizuar vizita të kota me një numër të madh të njerëzve të komunës, drejtorë edhe zyrtarë të ndryshëm ju keni mjete me i bë këto gjëra. Është për të ardhur keq për qasjen edhe për mënyrën e funksionimit të komunës së Vushtrrisë. Nuk ka përgjegjësi dhe llogaridhënie thjesht ka dalë prej kontrollit gjithçka. Për fat të keq ky kryetar veç e ka emrin kryetar sa për të u numëruar aty. Çdo gjë tjetër po shkon sipas tekeve dhe dëshirave të secilit individ ose grup të caktuar që ka interesa për me kryer punët e veta në komunë.

Ramadan Parduzi, anëtar i kuvendit-pasi i përshëndeti gjithë të pranishmit deklaroi se ka disa shqetësime ku nëpër fushatë elektorale është premtuar furnizimi me ujë të pijes për fshatin Shalë në Vushtri, projekt i cili moti është dashur të kryhet dhe akoma nuk është bërë asgjë lidhur me këtë projekt. Po ashtu në fshatin Kollë gjatë fushatës kryetari ka premtuar për nderimin e ujësjellësit, po nuk është bërë asgjë kur pritet të përfundoj. Mandej është një shqetësim tjetër tek rruga Ura Gurit, në lagjen Musliu, më konkretisht ish-veterani i luftës tashmë i ndërjerë Shaqir Musliu i cili ka 250 m rrugë, gjatë fushatës është premtuar rregullimi i asaj rruge por akoma nuk është bërë asgjë. Tutje një shqetësim tjetër nga qytetarët dhe prindërit të cilët më kanë shkruar dhe më kanë thirrur së paku që një javë ditë, tre katër herë në ditët, për lëvizjet me disa lodra (siç quhen ndryshe hulaqa) të cilat janë vendosur ndërmjet dy shkollave, kush i ka vendosur ato lodra, desha me ditë ku nxënësit prej orës dytë apo tretë asnjë orë tjetër nuk shkojnë 50% e nxënësve më shumë në mësim a ka mundësi veç me ditë, prej zyrtarëve kush ka qenë ai që ka dhënë leje për vendosjen e këtyre lodrave.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit- e nderuara kryesuese, të nderuar drejtorë të drejtorive, të nderuar kolegë asambleistë, anëtarë të KFOR-it, të shoqërisë civile, të dashur qytetarë. Edhe unë dua t'i ngriti disa shqetësime të qytetarëve. Së pari kisha pasur dëshirë me ditur cilat janë të mirat që do t'i vijnë komunës sonë nga vizitat e shpeshta që po i bënë kryetari i komunës dhe po e shohim që në këtë fillim të mandatit në shumicën e mbledhjeve të cilat i kemi edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa apo në mbledhjet që i kemi të rregullta pra nuk është prezent po arsyetohet që është jashtë vendit. Pra cilat janë të mirat e komunës edhe për qytetarët që kryetari i komunës i sjell nga këto vizita. Po vazhdon kryetari me ankesat gjatë intervistave se paratë po i merren për kontratë kolektive. Është mirë që kryetari t'u shpjegojë qytetarëve që kontrata kolektive është nënshtruar në vitin 2017 në kohën kur në qeveri ka qenë Partia Demokratike e Kosovës. Po më intereson, a e diskutoni brenda strukturave të Partisë Demokratike, dëmin e madh që keni bërë këtij vendi me një vendim që e keni marrë, pra qysh në vitin 2017 veç po bëhen 10 vite dhe pasojat e kësaj kontrate ose atij vendimi që e keni marrë janë shumë të mëdha për të gjithë qytetarët. A i diskutoni brenda strukturave të partisë tuaj dëme të cilat po shkaktohen vazhdimisht? Shqetësim

tjetër që po e ngriti janë punimet në shesh. Kemi ankesa të mëdha të qytetarëve për zhvillimin e punimeve respektivisht për dinamikën e punëve sepse ato po e shohim që këto ditë kur ishte pak më nxehtë u krijua një pluhur i madh. Bizneset po dëmtohen jashtëzakonisht shumë dhe po e shohim një kompani që punon me dy ose tre punëtorë dhe me zhvillimin e kësaj dinamike sigurisht që do duhen vite që të përfundojë. Një shqetësim tjetër vjen rreth deponive të mbeturinave në shumë fshatra të Vushtrrisë. Pra, kemi pasë kërkesa edhe më herët. Janë disa deponi edhe në fshatra dhe në qytet, por nuk po ndërmerret asgjë nga kompania për eliminimin e këtyre deponive. Po ashtu kemi parë këto ditë edhe kemi marrë ankesa të shumë qytetarëve që rrugët të cilat janë prishur gjatë vitit 2025, respektivisht në kohën e fushatës të zgjedhjeve lokale kanë mbetur në situatë të mjerueshme. A do të merrni ndonjë hap në mënyrë që këto rrugë të cilat kanë qenë gjendje pak më të mirë se që janë sot, pra kanë qenë të asfaltuara, i keni prishur me qëllim që t'ju merrni votën qytetarëve, pastaj i keni lënë gjendje të mjerueshme. E po ashtu për neve është shqetësuese blerja e veturave në këtë kohë nga ana e kryetarit të komunës në vlerë 90.000 €.

Fidan Bejta, anëtar i kuvendit-e nderuara kryesuese, përshëndetje drejtorë të drejtorive, përshëndetje kolegë të asamblesë komunale. Sot fillimisht dua një falënderim në emër tim edhe në emër të përfituesve për Drejtorin e Bujqësisë z. Besim Shyti, sepse qysh në fillim të mandatit kam pas shumë takime me të dhe me Bujq e blegtorë të cilët nuk kanë qenë përfitues të subvencioneve edhe drejtori ka punuar vazhdimisht që disa obligime të vitit 2024 dhe 2025 me i kryer ku fillimisht obligimet e vitit 2024 kanë përfunduar edhe shumë shpejt pritet me u kryer obligimet për vitin 2025. Andaj jam falënderues unë edhe gjithë përfituesit bujqit e Komunës së Vushtrrisë. Ai nuk ka qenë njëri prej përfituesve po ka qenë njëri prej atyre që kanë qenë adresë për me u kryer kjo punë edhe po dua me falënderuar drejtorin edhe publikisht për këtë punë edhe vazhdo drejtor me punë kështu. Sot e kam një kërkesë ku kërkoj nga të gjithë asambleistët një mbështetje financiare për një djalë nga Vushtrria i cili ka pasur një problem shëndetësor.

Kushtrim Veseli, anëtar i kuvendit-ngriti shqetësimin e tij në lidhje me ndërrimin e lokacionit të sallës së Kuvendit të Komunë së Vushtrrisë, dhe atë për të pyetur fare anëtarët e kuvendit. Ai deklaroi dhe u zotua se nëse kështu vazhdohet të veprohet, anëtarë e kuvendit do t'i sabotojnë mbledhjet e kuvendit.

Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit- sqaroi se si kryesuese e kuvendit, ka shqetësim për ndërrimin e lokacionit të sallës së kuvendit dhe është edhe i disa anëtarëve të kuvendit që kemi pasur takime herë pas here. Unë po dua me ju njoftu që do të thotë duke e përfshirë edhe veten edhe sekretarinë e kuvendit që si kryesuese e kuvendit zyrtarisht nuk kam asnjë informacion për këtë çështje që lidhet me lokacion e sallës së kuvendit.

Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit- tha se nuk dëshiron me u përsërit për dështimet që i keni të njëpasnjëshme e as arsyetime që po mundoheni me i bë e që tashmë nuk po ju pinë ujë. Nuk mundem me u arsytuar se s'kemi buxhet përderisa u përmendëm disa vizita, blerje veturash e të ndryshme para kolegëve të mi. Pyetje të cilat i kam konkrete njëra është për kryetarin e komunës direkt pse nuk po i zbaton kryetari vendimet e OSHP-së që po vijnë nga OSHP-ja për tenderët? Atëherë diskutimin ka të bëjë me tenderët të cilët kryetari i komunës nuk po i respekton vendimet e OSHP-së. Edhe pse OSHP-ja po i kthen mbrapa përzgjedhjen e operatorëve, kryetari merr guxim dhe ju jep prapë të njëjtin operator, tender. Nuk po jam e sigurt a është prapë e Ileja Group apo kush është, mirëpo të gjithë tenderët në mandatin e kaluar kanë shkuar tek i njëjti operator që është nga Skenderaj dhe të gjithë e dimë se për kë bëhet fjalë. Çështja tjetër që po dua me diskutuar dhe që duhet me u merr ju si qeverisje lokale është rruga tek Ura e Gurit. Çka po ndodh me rrugën tek Ura e Gurit. Drejtori tashmë veç doli dhe kjo është një mos respekt më së pari ndaj kryesueses së kuvendit, që asnjë drejtor nuk vjen dhe nuk jep llogari këtu. Jo vetëm sot por vazhdimisht tash e

gjithë mandatin. Tjetër kam kërkuar nga nga Drejtoria e Urbanizmit listën që është prej ndërtuesve afatet kur kanë aplikuar ndërtuesit kur janë përzgjedhur nuk e ka sjellë. Kam kërkuar nga Drejtoria e Financave edhe në mbledhjen e kaluar që me ma sjellë një dokument, ma paska sjellë, tash po njofton për borxhet totale që i ka komuna Vushtrrisë ndaj operatorëve ekonomikë.

Nasuf Aliu, anëtar i kuvendit- në adresimin e tij para kuvendit dhe qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë, ndër të tjera shtroi duke pyetur: Ka po shkon identiteti i Vushtrrisë? Në vijim diskutimi i tij u përqendrua rreth disa “investimeve” që po nisen dhe mbesin në gjysmë. Rreth mënyrës si po bëhen, kostos që po realizohet, opsioni se është investim i duhur apo jo? Rreth analizës dhe konsultimit paraprak me qytetarë dhe arkitektheve Vushtrriase, etj. Një duhet ta kemi parasysh, Vushtrria nuk është thjesht një hapësirë urbane në zhvillim e sipër, por Vushtrria është një nga qytetet më të vjetra në Kosovë, një vend ku shtresat e historisë lexohen në shumë rrugë dhe në çdo objekt që ka mbijetuar ndër shekuj. Që nga koha e Dardanisë, e më pas gjatë periudhave romake, bizantine e osmane, ky qytet ka qenë një nyje e rëndësishme historike dhe kulturore. Monumente historike si Kalaja e Vushtrrisë, Hamami apo Ura e Gurit nuk janë vetëm monumente, ato janë dëshmi të identitetit tonë kolektiv. Në këtë kontekst, investimet e fundit në renovimin e ndërtesave publike dhe kolektive janë të mirëseardhura dhe të domosdoshme sepse këtë çështje e kemi ngritur edhe zyrtarisht nëpër garimet tona politike që nga qershori i vitit 2016. Për vite me radhë, qytetarët kanë kërkuar përmirësim të kushteve të jetesës: termoizolim më të mirë, fasada funksionale, dyer e dritare cilësore, si dhe infrastrukturë që i përgjigjet nevojave bashkëkohore, përfshirë ashensorët në ndërtesat shumëkatëshe, pastrim podrumesh, etj. Këto nuk janë luks, por standarde bazë për një jetë dinjitoze. Megjithatë, ajo që po më shqetëson gjithnjë e më shumë është drejtimi estetik që po marrin këto ndërhyrje. Në shumë raste, renovimet po i zhveshin ndërtesat nga karakteri i tyre origjinal dhe po i shndërrojnë në struktura të zakonshme, me pamje të përgjithshme moderne, të ngjashme me çdo qytet tjetër. Vushtrria nuk duhet të humbë identitetin historik dhe të tentoj të garoj me pamjen e ndërtesave moderne, sepse jemi larg në mesin e kaosit urban dhe një qyteti aspak funksional me standard. Ky është një rrezik real, humbja graduale e identitetit. Një qytet historik nuk ndërtohet vetëm me të kaluarën, ai duhet të reflektohet edhe në të tashmen. Kjo do të thotë që investimet nuk duhet të kufizohen vetëm në funksionalitet, por të ndërtohen mbi një vizion të qartë për ruajtjen, forcimin dhe rritjen e shenjave të trashëgimisë dhe karakterit lokal. Renovimi nuk duhet të jetë sinonim i uniformizimit. Përkundrazi, ai duhet të jetë një proces që i rikthen dhe i thekson elementet autentike arkitekturore, duke i përshtatur ato me nevojat moderne. Shembuj të tillë ekzistojnë kudo në Evropë, por mjaft kemi edhe në rajon (Kroaci, si Rijeka, Opatija, në Shqipëri, si Gjirokastra, Berati, etj.), ku qytetet historike kanë arritur të balancojnë zhvillimin me ruajtjen e identitetit. Pse të mos jetë edhe Vushtrria një prej tyre? Kërkesa nuk është që të ndalen investimet por përkundrazi, ato duhet të vazhdojnë dhe të intensifikohen. Por ato duhet të udhëhiqen nga një strategji më e menduar mirë, ku përfshihen arkitektë, urbanistë dhe ekspertë të trashëgimisë kulturore. Duhet të vendosen standarde të qarta për rrënimin apo renovimet, në mënyrë që çdo ndërhyrje të kontribuojë në një pamje të përbashkët që e dallon qytetin, jo që e zbeh atë. Vushtrria ka potencial të jetë një qytet që jo vetëm jeton në histori, por edhe e tregon atë përmes pamjes së saj të përditshme. Nëse humbasim këtë drejtim, rrezikojmë të kemi ndërtesa më të rehatshme, por një qytet më pak të veçantë. Dhe kjo do të ishte një humbje që nuk mund të rikuperohet lehtë.

Isuf Jashari, drejtor i DBF-së-paraqiti sqarime me sa vijon: meqenëse u bënë disa pyetje që kanë implikime buxhetore dhe ka të bëjë edhe me financa publike, pata obligim që të dalë edhe t'i jap disa sqarime. Te çështja e blerjes së veturave. Ne absolut nuk kemi bërë kurrfarë veprimi ilegal. Po ka qenë legal. Po arsyeja pse është zhvilluar kjo procedurë për blerjen e veturave, momentin e

aprovimit të buxhetit për vitin 2026 ju jeni që e keni aprovuar buxhetin e keni tabelën 4.2 aty është blerja e automjeteve për komunën e Vushtrrisë, edhe çdo send ka shkuar në procedurë të rregullt. Çdo send është udhëhequr në atë formë dhe janë blerë dy automjete me mjete të planifikuara duke u bazuar tabelën 4.2. Më mirë është blerja e një veture që do të mbetet aset i komunës apo me marrë edhe katër pesë vetura me lizing që brenda një viti te ato mjete prapë ato vetura nuk i ke në pronësi komunale. Këto mbesin aset i komunës. Sa i përket hapjes së kodit ekonomik për vendimet gjyqësore dhe këtë shqetësim unë e kam ngritur edhe vitin e kaluar tek këtë vit nivelet qendror ka vepruar për sa i takon investimeve kapitale. Keni edhe raportin tremujor që e keni kodin 004 për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore përmbarimore në tabelën 4.2. Do të thotë tek këtë vit qeveria, përkatësisht Ministria e Financave në bashkëpunim me Departamentin e Thesarit e kanë hapur një kod të veçantë sepse edhe ne në financa kemi pas probleme shumë të mëdha në raportime. Nëse e sjellim raportin për vitin 2025 të investimeve kapitale, shpenzimet janë dalë 100% në realizimin i të gjitha projekteve de facto deri de jure mjetet i kanë marrë për vendime gjyqësore. Në këtë vit e kemi një risi që asnjë kontratë nuk mund të nënshkruhet pa pasur disponueshmërinë e mjeteve pa i pas mjetet e zotuar për tre vite, qoftë investime kapitale, qoftë mallra dhe shërbime. Misioni i atij trajnimi ka qenë me informuar mirë menaxherët e kontratave, drejtorët, zyrtarët që pa mjete buxhetore mos me hy në obligime. Edhe ka qenë menaxhimi i financave, shpenzimi i parasë publike, menaxhimi i kontratave. Krejt ky trajnim është realizuar në procedurë të rregullt dhe nuk ka pasur kurrfarë çmimi.

Fidan Bejta, anëtar i kuvendit- tha se siç edhe e paralajmërova më herët, sot vijë me një kërkesë pak më të veçantë tek asambleja komunale. Kërkoj mbështetje financiare për djalin e familjes Prishtina, një familje e respektueshme qytetit të Vushtrrisë, familje që ka dhënë kontribut të madh për sportin Vushtrrias. Amir Prishtina ka nevojë për një ndërhyrje, e cila duhet me u realizuar në Francë. Ky operacion kushton një shumë të mirë, kështu që kërkoj nga ju të votojmë edhe t'i ndajmë një vlerë prej 5.000 € mbështetje për operimin që ka me kryer në Francë. Operacioni ka me kushtuar diku mbi 15.000 € kështu që kush do e përkrah, kush s'do ndërjegjjen e tij le të mbetet.

Isuf Jashari, drejtor i DBF-së- kisha kërkuar nga ju të gjitha rastet të cilat janë të tilla sikur deputeti z. Fidan Bejta, është rast shumë emergjent në mënyrë që mos me na u kthyer vendimet nga MAPL-ja të bëhet kërkesa. Është një komision që bënë shqyrtimin e kërkesës edhe del me propozim ashtu qysh propozoni ju. Sepse shumë herë në këtë kuvend vitin e kaluar kemi marrë vendime të tilla. Na janë kthyer mbrapa për shkak se nuk është udhëheq procedura e ligjore si duhet. Po kemi problem edhe me auditorët. Momentin që po e bëjnë auditimin po e lyp kërkesën. Kurrfarë dokumentacioni s'po kem mbështetës. Kështu që çdo kërkesë që e keni është mirë të bëhet me shkrim. Është një komision për subvencione që shqyrton e prezanton këtu. Ju jeni ata që vendosni.

Berat Sadiku, anëtar i kuvendit- tha se i bashkëngjitëm kërkesës të anëtarit të kuvendit z. Fidan Bejta, mirëpo pajtohem edhe me atë që tha Drejtori i Financave. Presim që komisioni ta shqyrtoj kërkesën edhe pa dyshim që sigurt kuvendarët do ta mbështesin këtë kërkesë për ndihmë financiare. Tutje ai u ndal duke bërë vlerësime lidhur me rregulloren për menaxhimin e mbeturinave ku shtoj se dihet botërisht se Komuna e Vushtrrisë ka qenë dhe vazhdon të jetë shembull për komunat tjera në Republikë sa i përket menaxhimit të mbeturinave. Ky sukses nuk është rastësi, por rezultat i një pune të nisur dhe të ndërtuar gjatë qeverisjes së LDK-së, ku u arrit mbulimi i plotë i territorit – nga çdo shtëpi, biznes i vogël, i mesëm e i madh në qytet, e deri në fshatin më të largët të komunës sonë. Kjo praktikë e mirë, fatmirësisht, po vazhdon edhe sot. Megjithatë, nuk mund të anashkalohen ankesat e vazhdueshme të qytetarëve, të cilët po përballen

me vonesa të shpeshta në mbledhjen e mbeturinave. Për më tepër, këto vonesa nuk janë raste të izoluar, por po përsëriten gjithnjë e më shpesh, duke ndikuar drejtpërdrejt në cilësinë e shërbimit dhe në jetën e përditshme të qytetarëve. Duke pasur parasysh gjendjen e rënduar ekonomike të familjeve tona, zhvillimet globale dhe luftërat që kanë ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e çmimeve të produkteve bazë, konsiderojmë se në këtë fazë çdo rritje e tarifave për shërbime komunale është barrë shtesë dhe e papërbalueshme për qytetarët.

Konkretisht:

- Neni 9, pika 2.1 – Rritja e tarifës për ekonomi familjare rezidente nga 6€ në 10€ përbën një rritje prej rreth 66.7%, që është e lartë dhe e pajustificueshme në këtë kohë. Kjo tarifë duhet të mbetet në nivelin aktual prej 6€.
- Neni 9, pika 2.2 – Tarifa prej 40€ për ekonomi familjare jorezidente është e tepruar dhe nuk reflekton realitetin. Duke ditur që diaspora jonë kryesisht qëndron për periudha të shkurtra gjatë verës, një tarifë prej 20€ do të ishte më e arsyeshme dhe nuk do të rëndonte pa nevojë bashkatdhetarët tanë.
- Neni 9, pika 3.4.1 dhe 3.4.1.1 – Rritja e tarifave për subjektet e mesme dhe të mëdha komerciale është gjithashtu e tepruar. Konsiderojmë që kontejneri i parë mund të mbetet me tarifë 14€, ndërsa zbrazjet tjera të tarifohen me 10€, si një zgjidhje më e balancuar dhe më e përbalueshme për bizneset.

Në vend të rritjes së tarifave, komuna duhet të fokusohet në përmirësimin e cilësisë së shërbimit dhe në eliminimin e vonesave që tashmë janë bërë shqetësim serioz për qytetarët. Në këto rrethana ekonomike dhe duke parë mangësitë në ofrimin e shërbimeve, ne e kundërshtojmë këtë Draft-Rregullore në këtë formë, duke kërkuar rishikim të saj dhe reflektim në interes të qytetarëve.

Melihate Basholli-Latifi, kryesues e kuvendit- kërkoj të futet në rendin e ditës propozim-vendimi për korrigjimin e vendimit për themelimin e Komitetit për Komunitete. Gabimi teknik konsiston sa i përket mbiemrit nga Burgazi në Ramadani dhe emri nga Fahrije bëhet Florije Ramadani.

Kuvendi pas votimit me 25 vota “për” 3 vota “abstenim” aprovoj për inkorporim në rendin e ditës propozim-vendimin për korrigjimin e vendimit lidhur me themelimin e Komitetit për Komunitete.

Fidan Bejta, anëtar i kuvendit-deklaroi se vullneti i tij dhe i gjithë kuvendit është që t’i dalim në ndihmë z. Amir Prishtina, por propozon që kjo kërkesë ti kaloj filtrat ligjor dhe me pas të vjen në seancën e kuvendit për aprovim.

Refik Maloku, anëtar i kuvendit- propozon një zgjidhje të mesëm për të ofruar ndihmë financiare z. Amir Prishtina, që vlera prej 2000 € ti ndahet me vendim të kryetarit të komunës, ndërsa pjesa tjetër në seancën e ardhshme me vendim të kuvendit.

Leonora Gërguri, anëtare e kuvendit-tha se si kjo pikë edhe shumë pika të tjera na kanë ardhur këso kërkesë edhe në të kaluarën edhe shumë shpesh drejtori na ka thënë që s’ka buxhet edhe kisha dashur që ne me e largu këtë praktikë si kuvend, që secila kërkesë dhe ne këto të gjithë jemi për me i përkrah sidomos pacientët edhe në rastet emergjente veç ka mundem me ju thënë ne si kuvend atyre që janë në listën të Drejtoria e Shëndetësisë edhe që nuk e njohin askënd këtu prej nesh edhe ata duhet me prituri ndoshta kanë edhe më shumë urgjenca kështu që besoj që kishte me

qenë mirë që këto praktika me i ndaluar ne vetë si kuvendarë. Edhe as mos me ju vu juve si ekzekutiv në kësi pozite si kjo. Çështje urgjente mund me qenë lloj lloj situatash. Unë nuk jam kundër edhe tash nëse e kishit proceduar, unë e kisha votuar *pro*, veç nuk duhet të veprohet me standarde të dyfishta duke i privilegjuar dike e dikë jo.

Pas debatit jashtë rendit të ditës dhe për rendin e ditës, Kuvendi pas votimit me 27 vota “për”, 1 votë “abstenim”, aprovoi këtë:

R E N D D I T E

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 31 mars 2026;
2. Raport i shpenzimeve për periudhën janar – mars 2026;
3. Propozim-vendim për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private në rr. “Ismail Parduzi” në Vushtri sipas gjendjes faktike;
4. Propozim – vendim për formimin e komisionit për ndryshim-plotësimin (hartimin) e rregullores për punën e kuvendit.
5. Propozim – vendim për korrigjimin e vendimit të Kuvendit të Komunës lidhur me themelimin e Komitetit për Komunitete;
6. Pyetje dhe përgjigje.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 31 mars 2026;

Nasuf Aliu, anëtar i kuvendit-paraqiti vërejtje sa i përket një diskutimi të tij në procesverbalin e mbledhjes së datë 31 mars 2026, këto vërejtje u inkorporuan në procesverbal sipas sugjerimeve të tij.

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi me 25 vota “për” miratoi Procesverbalin nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 31 mars 2026, më vërejtjet e paraqitura.

2. Raport i shpenzimeve për periudhën janar – mars 2026;

Berat Sadiku, anëtar i kuvendit- tha se sot po diskutojmë *raportin e shpenzimeve për periudhën janar–mars 2026*, i cili në pamje të parë mund të duket i balancuar, por në përmbajtje nxjerr në pah probleme serioze në menaxhimin e parasë publike. Së pari, edhe pse kemi një ulje të lehtë të totalit të shpenzimeve operative krahasuar me vitin e kaluar, struktura e tyre është shqetësuese. Shohim rritje të pakontrolluara në disa kategori kyçe, që nuk janë të justifikuara. Një ndër shembujt më flagrant është rritja e shpenzimeve për energji elektrike nga **91,995 € → 205,763 €** (rritje mbi 100%), e cila është më shumë se dyfishuar. Kjo ngre pyetje të drejtpërdrejta: a kemi ndërmarrë ndonjë masë për efikasitet energjetike, apo po paguajmë çmimin e një menaxhimi të dobët? Edhe më shqetësuese është rritja enorme në mirëmbajtjen e rrugëve lokale nga **5,016 € → 711,398 €** (rritje ekstreme mbi 100 herë). Kjo nuk është rritje normale – kjo kërkon transparencë të plotë. Cilat projekte janë realizuar? Me çfarë procedurash? Dhe pse nuk janë planifikuar në mënyrë më

të qëndrueshme? Rritja e shpenzimeve për derivate nga 9,596 € → 31,309 € (ritje mbi 300%) tregon qartë mungesë kontrolli dhe menaxhim joefikas të përdorimit të automjeteve zyrtare. Po ashtu, shohim rritje në shpenzimet administrative si furnizimet për zyre nga 16,583 € → 33,453 €, ndërkohë që bien investimet në mirëmbajtjen e ndërtesave nga 32,500 € → 1,680 € dhe pajisjeve që ishte dashur të jetë e kundërta. Kjo tregon një zhbilancim të qartë të prioriteteve. Në anën tjetër, subvencionet janë ulur në total, por kemi rritje të transfereve për individë dhe vazhdojmë të kemi një nivel të lartë të pagesave nga vendimet gjyqësore. Kjo tregon për mungesë të parandalimit të kontesteve dhe menaxhim joefikas ligjor. Të gjitha këto tregojnë një gjë të vetme: mungesë planifikimi afatgjatë dhe mungesë kontrolli mbi shpenzimet. Qytetarët e Vushtrrisë meritojnë më shumë se shpenzime të paarsyetuara – ata meritojnë zhvillim, efikasitet dhe llogaridhënie.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit- fillimisht të falënderoj Drejtorin e Drejtorisë për Financa që e ka sjellë përmbledhjen e shpenzimeve të investimeve kapitale të përmirësuar, sepse në Komitet për Politikë dhe Financa ka qenë një raport me shumë gabime dhe si zakonisht ashtu siç është krijuar një praktikë e mëhershme po i quani gabime teknike po kam thënë edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa që ka qenë një raport me gabime goxha përmbajtjesore. Sa i përket raportit të shpenzimeve për periudhën janar mars 2026, shihet që kemi rritje të shpenzimeve të udhëtimit brenda vendit, po ashtu rritje të shpenzimeve për mëditje të udhëtimeve zyrtar brenda vendit, shpenzime të vogla ose para xhepi po ashtu. Këtu krahasuar me vitin e kaluar kemi rritje enorme, rritje të shpenzimeve të akomodimit të udhëtimit jashtë vendit, shpenzimet teknike po ashtu rritje enorme nga 9.000€ në 23.894 €. Furnizimet për zyre po ashtu rritje të shpenzimeve furnizime me ushqim dhe pije, dreka jo zyrtare po ashtu një rritje shumë e madhe. Sa i përket sigurimit të automjeteve, po ashtu një rritje enorme nga 480€ në 3483 €. Tek mirëmbajtja e rrugëve lokale, e kam thënë edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa, po e ritheksoj edhe këtu se nga 5.000 € në 711.000 € euro. Kjo dëshmon që jo gjatë vitit të kaluar, sidomos gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, zgjedhjeve lokale, keni hyrë në borxh edhe në obligime dhe tash po obligoheni që ato t'i kryeni me shumë vonesa. Po ashtu tek qiraja për automjete, unë nuk e di nëse vitin e kaluar kanë qenë 11.000 € këtë vit janë 22.000 €. Pra një rritje shumë e madhe. Pra keni automjete me qira. Tash i keni blerë edhe automjete të tjera. Nuk e di a i keni këto automjete me qira edhe për prej kështu afatgjatë apo janë vetëm për këtë vit në mënyrë që ta kurseni paratë publike. Pra shihet që në përgjithësi është një rritje dhe shpenzime të cilat janë kryesisht për luks ashtu siç dini edhe siç i keni bërë edhe në qeverisjen e kaluar po vazhdoni edhe në këtë mandat.

Benjamin Shala, drejtor i DSHP-së- pasi i përshëndeti të pranishmit tha se raporti tremujor i vitit 2026 evidenton se afektohet prej vendimeve përmbartimore të vitit të kaluar për arsye se vendimet përmbartimore na kanë goditur edhe në kodin ekonomik komunal domethënë ku kanë qenë edhe shpenzimet e rrymës. Shtoja kësaj edhe rritjen domethënë që ka ndodhur vitin e kaluar edhe komplet obligime që barten në këtë viti dhe kështu ky raport del shumë më i fryrë se i vitit të kaluar. Tek mirëmbajtja e rrugëve periudhën e njëjtë të vitit të kaluar nuk kemi pasur kontratë të mirëmbajtjes së rrugëve. Domethënë është lëshuar kontrata diku te fundi i marsit. Kemi punuar tërë kohën edhe normal obligimet e vitit të kaluar janë bartë për këtë vit edhe janë kryer një pjesë e obligimeve në tremujorin e parë edhe të derivateve të veturave edhe obligime të vitit të kaluar edhe rritja e enorme e çmimit të naftës e ka bërë të vetën. Ndërsa edhe te rritja e qirasë është e njëjta e ndjeva obligim të dal me i sqaruar këtu se lidhem komplet me drejtorinë. Mirëpo të gjitha janë jo vetëm këto por të gjitha shpenzimet tjera afektojnë tek plani tremujor i këtij viti prej obligimeve të vitit të kaluar.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendit pas votimit me 19 vota “për” aprovohet Raporti i shpenzimeve për periudhën janar – mars 2026.

3. Propozim-vendim për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private në rr. “Ismail Parduzi” në Vushtrri sipas gjendjes faktike;

Refik Maloku, anëtar i kuvendit- tha se është krijuar një farë opiniononi që ne të Vetëvendosjes jemi të gjithë kundër, atyre që ndërtojnë e atyre që punojnë. Në fakt këtë e keni ndërtuar ju si narracion. A krejt çka jeni ne, është që të zbatohet ligji kur bëhet një punë apo jepet në shfrytëzim apo këmbim i një prone komunale. Pra ne jemi për me u zbatuar ligji kur kryhet një punë. Ne e kemi pas një shqetësim para disa mbledhjeve. Ka qenë çështja e ndërrimit të pronës në rrugën “Ismail Qemili” tek ndërtesa që është ndërtuar. Ne kemi kërkuar nga Drejtoria e Gjeodezisë dhe Kadastrit që me na sjellë në mënyrë të detajuar cilën pjesë e kemi dhënë edhe cilën pjesë e kemi marrë në gjendje faktike nëse e sheh ndërtesën që u ndërtuar në rrugën “Ismail Qemali”, tregon që ne veç keni dhënë pronë e nuk kemi përfituar asgjë. Kështu që ne tash i kemi dilemat. Ne duam me ju ndihmuar qytetarëve të asaj që është ndërtuar ndërtesa me pas një rrugë me të cilën kalohet. Ne jemi në dilemë për arsye se ju nuk jeni korrekt në zbatimin e vendimeve të cilat i marrim si komunë dhe si kuvend i komunës. Do të thotë ajo çfarë meriton të trajtohet është fakti se ne e kemi votuar njëherë një ndërrim të pronës, se kemi votuar të gjithë, dhe ne nuk kemi pasur kurrfarë informate dhe asnjë përshkrim të ndërrimit të asaj pronës, sa i kemi dhënë edhe sa i kemi marrë, nga ky këmbim.. E tash dilema jonë është kjo a jemi duke ndihmuar këtë proces, edhe sa jemi të sigurtë ju kur e bëni ndërrimin e pronave. Domethënë sinqeriteti juaj me treguar se çka kemi dhënë edhe çka kemi marrë mungon. Për ata ne nuk jemi për me i bë këto ndërrime për arsye se ju jeni jo të sigurtë në këto ndërrime të pronave komunale.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit- tha se po më vjen mirë që e keni plotësuar vendimin edhe na e keni sjellë edhe pikën e tretë të vendimit. Pra e keni sjell vlerësimin e pronave të paluajtshme që e ka bërë Ministria e Financave Punës dhe Transfereve. Po e kam thënë edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa, po e potencoj edhe këtu, nuk e di a është ndonjë përfaqësues i kësaj drejtorie, tek pjesa e pronës, tek pronari ku është tek fleta poseduese tek komuna e Vushtrrisë thuhet që pjesa e pronës është 1/1 që i bëjnë që Komuna e Vushtrrisë është 100% pronare kurse, tek fleta poseduese që është në emër të kompanisë e cila ka kërkuar me bë ndërrimin tek pjesa e pronës në pjesa e parë është 4/18 kurse, pjesa e dytë është 6/2. Prandaj nga konsultimet që i kam pas me ekspertë edhe me njerëz të fushave përkatëse më kanë thënë që kjo 4/18 dhe 6/2 tregon që pronari nuk është 100%. Pra këtu ka edhe pronarë të tjerë. Pra pjesa e pronës, ne po duam me dhënë dikujt tokë që jem pronarë vetë 100% po me marrë prej dikujt që nuk është pronar. Prandaj kisha kërkuar sqarim këtu. Pra është diçka që është e jashtëligjshme dhe sikur kish pasur mundësi Drejtori me qenë këtu ose personat që janë, të kësaj fushe me na shpjeguar ose me e shfrytëzuar edhe ekranin me e qitë ku është ajo pronë, me u ditur sakë pronari 100% edhe njëmend me u heq ajo bindja që Vetëvendosja është veç kundër po ne jemi kundër sepse po bëjmë shkelje të ligjit. Prandaj nëse vërtetohet që nuk është pronari 100% sigurisht ne si Lëvizje Vetëvendosje kemi me dërguar edhe në instanca të tjera dhe kjo kthehet e paligjshme. Si është kthyer edhe më herët se kjo çështje u vendos në vitin 2025 u kthye për shkak të shkeljeve procedurale.

Berat Sadiku, anëtar i kuvendit-tha se grupi i kuvendarëve të LDK-së, duke shqyrtuar Propozim-Vendimin për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së

paluajtshme komunale me pronë private në rrugën "Ismail Parduzi" në Vushtrri, fillimisht vlerëson se kjo çështje kërkon trajtim të kujdesshëm për shkak të ndjeshmërisë që ka menaxhimi i pronës publike. Pavarësisht raportit të dorëzuar nga departamenti për vlerësimin e pronave të paluajtshme dhe konstatimit të përputhshmërisë formale të vlerës, si dhe këmbimit të paraqitur në raport të barabartë prej 161 m² me 161 m², ne konsiderojmë se barazia në sipërfaqe nuk nënkupton domosdoshmërisht barazi reale në vlerë, duke marrë parasysh gjendjen faktike në terren. Prona komunale që propozohet për këmbim ndodhet në një pozitë strategjike veçanërisht në kontekst të realizimit të projekteve afaristo-banesore. Në anën tjetër, prona që i ofrohet komunës në këmbim është një hapësirë e destinuar për rrugë me gjerësi rreth 2.2 metra, e cila në praktikë nuk përmbush standardet e zakonshme të infrastrukturës funksionale urbane dhe, si e tillë, ka një përdorim më të kufizuar. Kjo krijon një perceptim të një disbalance në vlerën reale të pronave që janë objekt i këmbimit. Andaj, konsiderojmë se raporti fillestar i hartuar nga Drejtoria e Kadastrit dhe Drejtoria e Urbanizimit është dashur të jetë më i plotë, më i qartë dhe më i argumentuar në aspektin profesional. Megjithatë, pavarësisht këtyre vërejtjeve, Grupi Kuvendarë i LDK-së e sheh këtë çështje edhe në prizmin e zhvillimit urban dhe rregullimit hapësinor të zonës në fjalë. Ne vlerësojmë se realizimi i këtij këmbimi, nëse shoqërohet me zbatim të rregullt të standardeve planifikuese dhe ndërtimore, mund të kontribuojë në krijimin e një rregulli më të mirë urban në këtë pjesë të qytetit. Ky këmbim mundëson një pozicionim më racional të objekteve, shmang fragmentimin e parcelave dhe krijon kushte për një zhvillim më të harmonizuar dhe estetikisht më të pranueshëm të zonës. Në rast të mosmiratimit të këtij propozimi, ekziston rreziku që të krijohet një vakum urbanistik dhe një mospërputhje në pozicionimin e objekteve, që do të ndikonte negativisht në zhvillimin e ardhshëm të kësaj hapësire. Për këto arsye, duke balancuar vërejtjet tona me interesin më të gjerë për rregullimin urban dhe funksional të zonës, Grupi i Kuvendarëve të LDK-së e përkrah në parim këtë Propozim-Vendim. Andaj si grup kuvendarë ne përkrahim një propozim të tillë dhe seancat e ardhshme do të kemi edhe çështje tjera të ngjashme që do të sillen për aprovim. Unë pasi që edhe jam arkitekt, unë besoj që kemi me pasur kërkesa të tjera dhe të tilla, mirëpo do t'i mbrojmë ato shkëmbime të pronave që je me interes edhe të qytetarëve edhe të Komunës së Vushtrrisë.

Fidan Bejta, anëtar i kuvendit-tha se kur është puna te pronat dhe ana profesionale që lidhet me anëtarin e kuvendit z. Berat Sadiku, unë e kam besim që ai i njeh gjërat, ka përvojë edhe po besoj që e ka me të drejtë. Po është krijuar pak edhe te një pjesë e asamblesë dhe te një pjesë e qytetit dhe e qytetarëve që në disa raste kam votuar kundër, disa raste kam me abstenuar edhe çka dhe pse po del kundër, këtyre çështjeve të pronës. Po dua njëherë e përgjithmonë me sqaruar te pjesa ku është prona komunale, asnjëherë në jetën time nuk kam me marrë vendim që nesër me i ra pishman. Kështu që për një temë që unë ndihem i pasigurt vendosi me votuar kundër ose me abstenuar. Kështu që edhe njëherë po them kur vjen puna për pronat publike duhet me pas kujdes gjithsecili. Po pajtohem me z. Berat Sadiku që nuk është diçka e jashtëligjshme ose diçka që po na vjen me humbë neve si komunë. Por, unë personalisht nuk du me gabu për veten time. Kështu që, veç një sqarim desha me dhënë: nuk jam prishur me kryetarin, nuk jam prishur me asamblistët e PDK-së. I kam vendimet e mia që i respektoj.

Ilmi, Zeqiri, shef i Sektorit për Kadastër-paraqiti sqarime lidhur me çështjet e ngritura nga anëtarët e kuvendit, ku ceku se sa i përket pronësisë së parcelës në fjalë, posedimit të parcelës në fjalë që është objekt i shqyrtimit për ndërrim, nuk ka dilemë që Ariani Company SH.P.K është pronar e parcelës në tërësi. Ai shtoj se deri te ky gabim teknik ka ardhur sepse Ariani Company para se me bashkuar parcelën ka pasur parcela të regjistruara edhe me numër të biznesit të vjetër edhe me të ri. Kjo ka bërë që automatikisht sistemi e ka njohtë si dy bashkëpronar. Në

kolonën e parë e kemi kompaninë Ariani Company numri i biznesit unik 81106, te kolona e dytë e keni numrin e certifikatës së biznesit të vjetër. Po kemi të bëjmë me të njëjtën kompani edhe me një kërkesë të Ariani Company, kjo në Kadastër mundet me u rregulluar brenda ditës domethënë nuk ka kurrfarë dileme që kemi të bëjmë me një subjekt të vetëm ekonomik. Pronësia është nuk është diskutabile absolutisht. E sa i përket arsyeshmërisë të propozim-vendimit, unë nuk jam i thirrur për me fol me të për se s'kam bërë pjesë as në hartim as nuk jam në dijeni. Sa i përket pronësisë nuk kemi kurrfarë problemi sepse kjo mund të rregullohet me një kërkesë të thjesht brenda ditës. Me anë të kërkesës së parashtruar nga subjekti i cekur si më lartë, bëhet bashkimi i personave me ID të ndryshëm ashtu quhet bëhet korrigjimi në sistem. Prandaj konstatoj se sa i përket pronës së parcelës për të cilën u ngritën dilema, nuk ka kurrfarë dyshimi se kemi të bëjmë me një subjekt të vetëm ekonomik, Ariani Company SH.P.K.

Refik Maloku, anëtar i kuvendit-tha se kur bëhet fjalë për dhënien e pronave në shfrytëzim, atëherë duhet konstatuar se kemi krijuar një praktikë jo të mirë. Kjo për faktin se diçka tjetër po vendos kuvendi e krejt diçka tjetër po zbatohet në praktikë.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 19 vota “për”, 8 vota “kundër” dhe 1 votë “abstenim”, vendosi si vijon:

1. Miratohet propozimi i kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajshme komunale me pronën e paluajshme në pronësi të Ariani Company SH.P.K me pronar Naser Imeri.
2. Pronat e paluajshme që do të këmbehen kanë këto karakteristika: Pjesë nga parcela kadastrale **P-70202016-6570-0** në sipërfaqe prej **161m²**, nga sipërfaqja e përgjithshme prej **5267m²** zK Vushtrri pronë e Ariani Company SH.P.K, me pjesë nga parcela kadastrale **P-70202016-1106-1-0**, në sipërfaqe prej **161 m²**, nga sipërfaqja e përgjithshme prej **3707m²**, zK Vushtrri pronë e Komunës së Vushtrrisë. Këmbimi i pronës së paluajshme është bërë pasi që nuk ekzistojnë parcela të tjera komunale të përshtatshme për zgjerimin e rrugës- kyçje në rrugën publike rr. “Gjon Buzuku”, bazuar në profilin e rrugës sipas Planit Zhvillimor Komunal 2016-2024.
3. Këto prona u janë nënshtruar vlerësimit të pronave nga Zyra për Vlerësimin e Pronave të Paluajshme pranë Departamentit për Vlerësimin e Pronave të Paluajshme në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve.
4. Pronat e paluajshme që do të këmbehen, të përshkruara në pikën 2 të këtij vendimi, duhet të evidentohen në elaboratin kadastral (librat kadastral) të Komunës.
5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit.
6. Ky vendim hynë në fuqi tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.
4. Propozim – vendim për formimin e komisionit për ndryshim-plotësimin (hartimin) e rregullores për punën e kuvendit.

Pas shqyrtimit dhe dhënies së propozimeve, kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim formohet komisioni për ndryshim-plotësimin (hartimin) e Rregullores për punën e kuvendit dhe organeve të tij, në përbërjen si në vijim:

1.1. Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e Kuvendit dhe komisionit (PDK);

1.2. Kushtrim Hyseni, anëtar i kuvendit (PDK);

1.3. Drita Dibrani, anëtare e kuvendit (LVV);

1.4. Leonora Gërguri, anëtare e kuvendit (LDK);

1.5. Kushtrim Veseli, anëtar i kuvendit (Nisma Socialdemokrate);

1.6. Mensur Kastrati, anëtar i kuvendit (AAK) dhe

1.7. Alban Tahiraj, Zyra Ligjore e Komunës.

2. Komisioni i cekur në pikën një (1) të këtij vendimi, do të bëjë plotësim-ndryshimin (hartimin) e draftit të kësaj rregulloreje dhe të njëjtën do ta procedojë në kuvend për aprovim.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: anëtarët e komisionit të cekur në pikën një (1) të këtij vendimi.

4. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

5. Propozim – vendim për korrigjimin e vendimit të Kuvendit të Komunës lidhur me themelimin e Komitetit për Komunitete;

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 27 vota “për” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim korrigjohet vendimi i kuvendit me Nr.5100/26 i datës 29.01.2026 lidhur me themelimin e Komitetit për Komunitete, si në vijim:

1.1. Korrigjohet gabimi teknik i pikës 1.7. të vendimit Nr.5100/26, ku nga znj. Fahrije Burgazi, bëhet znj. Florije Ramadani.

2. Gjatë hartimit të vendimit të kuvendit Nr.5100/26 i datës 29.01.2026 lidhur me themelimin e Komitetit për Komunitete, është lëshuar një gabim teknik sa i përket emrit të përfaqësueses së komunitet rom, ku ishte shënuar gabimisht emri i znj. Fahrije Burgazi, e që është dashur të jetë Florije Ramadani, (mbiemri Burgazi është mbiemri i vajzërisë dhe bëhet fjalë për personin e njëjtë).

3. Pjesët tjera të vendimit bazë Nr.5100/26 të datës 29.01.2026 lidhur me themelimin e Komitetit për Komunitete, mbasin të pandryshuara.

4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Zyra për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore dhe Sekretaria e Kuvendit.

5. Ky vendim hynë në fuqi tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

6. Pyetje dhe përgjigje.

Refik Maloku, anëtar i kuvendit-kërkoj raport me shkrim nga drejtori i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, lidhur me këmbimin e pronës komunale me pronën private në rr."Ismajl Qemajli" konkretisht te ish lokali "Sueno".

Betim Grabnica, anëtar i kuvendit-pyeti drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, ku ju referua një fotos, ku janë duke u shtruar kanalizimet, pa u shtruar zhavorri, kjo ka ndodhur saktësisht në fshatin Nadakoc, ku fotot janë publike. Prandaj pyetja është se pse po shtrohen pa zhavorr kanalizimet? Po ashtu në këtë kontekst kërkoj sqarime sa a ka ndryshuar ndonjë gjë në procedurat e prokurimit sepse në specifikacion shënohet se kanalizimet shtrohen gjithherë me zhavorr.

Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit-pyeti kryesuesen e kuvendit se, pse po mbahet aq afër mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa me mbledhjen e kuvendit, a është kjo ligjore nëse kështu mbahen këto mbledhje?! Po ashtu ajo kërkoj barazi edhe për sa i takon shqyrtimit të kërkesave për ndihmë financiare për shërim.

Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit-sqaroi se mbledhjet e KPF-së dhe të kuvendit të komunës janë duke u mbajtur krejtësisht në suaza ligjore. E rëndësishme është që të respektohet çdoherë afati shtatë ditor për dërgimin e materialeve.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-tha se, pyetja e tij lidhet me një rrugë të rendit të katërt në fshatin Stanoc i Epërm, që në vitin 2024, Drejtoria e Emergjencave, e njëjta është rrugë pa emër por që lidhë shumë parcela shumë toka bujqësore dhe në vitin 2024 Komuna e Vushtrrisë respektivisht Drejtoria e Emergjencave, dhe drejtori z. Maliq Ferizi, e ka bërë një punë të mirë duke angazhuar një kompani dhe ka bërë hapjen e rrugës dhe kjo ka mundësuar qasje në punimin e tokave rreth 100 hektar tokë. Në atë rrugë është një vend që është i mbuluar me ujë një sipërfaqe e konsiderueshme, ku aty kanë mbetur disa gypa pa u vendosur dhe si pasoj e kësaj është grumbulluar uji. Prandaj pyetja është se kur do të merren veprimet për t'i vendosur ata gypa në atë rrugë?!

Ramadan Parduzi, anëtar i kuvendit-pyeti, kur do të bëhet furnizimi me ujë të pijes në fshatin Shallic? Kur do të bëhet shtrimi i rrugës "Ura e Gurit"? Si dhe kur do të bëhet dislokimi i atyre lodrave-hulaqave mes dy shkollave, sepse ka ankesa nga prindërit?!

Isa Hajrizi, drejtor i Drejtorisë së Emergjencave-tha se, jam në dijeni për problemet në rrugën e fshatit Stanoc i Epërm dhe u zotua se shumë shpejt do të ndërmerren veprimet e duhura për sanimin e atyre problemeve me gypa, për t'ju mundësuar bujqëve punimin e lirshëm të tokave të tyre.

Mbledhja përfundoj në ora 11:55

Bastri Duraku


Procesmbajtës



Melihate Basholli-Latifi



Kryesuese e Kuvendit